



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 29
Prishtinë, më 23 gusht 2011

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 23 GUSHT 2011**

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në mbledhje janë të pranishëm 75 deputetë dhe deklaroi të hapur punimet e sesionit vjeshtor të Kuvendit.

Ai i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Në fillim të mbledhjes, kryetari ia dha fjalën kryeministrit të Kosovës, i cili e informoi Kuvendin lidhur me zhvillimet e fundit që kishin ndodhur në veriun e Kosovës.

Në vazhdim, kryeministri **Hashim Thaçi** tha se Qeveria e Republikës së Kosovës, më 20 korrik kishte marrë vendim për aplikimin e masave të reciprocitetit për mallra që janë importuar nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina.

Ky vendim ka filluar të zbatohet në të gjitha pikat kufitare menjëherë, me përjashtim të pikës 1 dhe 31 në veri të vendit, ku policët kufitarë të nacionalitetit serb, së bashku me policët e EULEX-it, kanë refuzuar të zbatojnë vendimin për ndalimin e mallrave që vijnë nga Serbia.

Si rrjedhje e kësaj, me 25 korrik, unë si kryeministër, në bazë të autoritetit tim kushtetues, kam autorizuar Policinë e Kosovës që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për vendosjen e sundimit të ligjit dhe zbatimin e vendimit për reciprocitet në pikën 1 dhe 31.

Pas përfundimit të operacionit të njërive speciale të Policisë së Kosovës, në veri të vendit, u krijuan kushtet që policia e rregullt kufitare dhe doganierët e Republikës së Kosovës të vendosen në pikën 1 dhe 31. Fatkeqësisht, më 27 korrik, një grup i organizuar kriminal, i udhëhequr nga liderë të strukturave kriminale serbe dhe të motivuara nga autoritetet e Beogradit, kanë sulmuar fillimisht pikën 1 dhe më pas atë 31.

Të gjithë faktorët ndërkombëtarë kanë qenë të informuar tash e dymbëdhjetë vjet e gjysmë për gjendjen e pa tolerueshme në veri. EULEX-i ka hezitur të jetë mbështetës i vendimit të institucioneve të Republikës së Kosovës për vënien e rendit dhe të ligjit. Por, pas vendimit dhe veprimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ai është deklaruar se dëshiron dhe është i gatshëm të punojë në përputhshmëri me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës.

Ne kemi pasur dhe vazhdojmë të kemi një bashkëpunim të shkëlqyeshëm me KFOR-in, për çka falënderoj gjithë stafin komandues në krye me gjeneralin Bühler. KFOR-i dhe Qeveria e Kosovës kanë bërë marrëveshjen e përkohshme për deblokimin e rrugëve, për mbajtjen e situatës nën kontroll nga ana e trupave të KFOR-it. Fatkeqësisht, marrëveshja në mes Qeverisë së Kosovës dhe KFOR-it nuk është respektuar në tërësi dhe ka barrikada që nuk janë hequr nga rrugët. Ne vazhdojmë të kemi besim në autoritetin e KFOR-it për përmbushjen e zotimeve që dalin nga kjo marrëveshje, mirëpo ne do të vazhdojmë përkushtimin tonë deri në fund për rend dhe ligj. Tani, Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare kanë qëndrime unike për veriun e vendit pas 12 vjet e gjysmë, që do të thotë se nuk do të ketë kthim në gjendjen e para 25 korrikut. Kjo është konfirmuar nga Brukseli dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nëpërmes zyrtarëve të lartë që vizituan Republikën e Kosovës javëve të fundit.

Tani është hapur një kapitull i ri i sovranitetit të plotë të Republikës së Kosovës dhe në asnjë rrethanë nuk do të ketë kthim prapa. Përkundrazi, duhet të punojmë të gjithë për të konsoliduar gjendjen. Qeveria e Republikës së Kosovës dhe organet që janë përgjegjëse për rend dhe ligj, do të jenë të pa kompromis dhe me çdo çmim do të sjellin para drejtësisë përgjegjësit për vrasjen e policit dhe heroit të Kosovës, Enver Zyberaj, dhe për djegien e pikës kufitare.

Krimi i organizuar në veri, strukturat kriminale në veri nuk janë rrezik lokal, janë rrezik për rajonin dhe do të jemi të pa kompromis kundër tyre.

Qeveria e Republikës së Kosovës punon me këmbëngulje që të integrojë gjithë komunitetin serb në jetën e re demokratike, në një proces elektoral demokratik, ku qytetarët atje do të kenë mundësi të zgjedhin përfaqësuesit e vet në institucione lokale dhe qendrore, që të krijohen kushtet dhe mundësitë më të mira për të investuar, ndërsa falënderoj që gjithnjë e më tepër ka distancim prej këtyre strukturave kriminale të shumicës së qytetarëve në veri.

Në fund, kryeministri falënderoi Kuvendin e Kosovës për mbështetjen që iu kishte dhënë veprimeve të ligjshme të Qeverisë për sundimin e rendit dhe të ligjit në veri të vendit, me anë të një rezolute, të miratuar më 28 korrik 2011.

Kryetari i Komisionit për Integritet Evropian, Lutfi Haziri, propozoi që shqyrtimi i Raportit të parë për zbatimin e Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian, për vitin 2011, të radhitet si pika e katërt e rendit të ditës.

Kuvendi miratoi propozimin e z. Haziri.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i Raportit të parë për zbatimin e Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian, për vitin 2011,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregti me jashtë,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për marrëveshjet ndërkombëtare,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Qendrën historike të Prizrenit,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Organizmat e modifikuar gjenetikisht,
11. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Kompanisë së Ujësjellësit rajonal “ Hidrodrini” për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010,
12. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2010,
13. Propozimi i Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re për emërimin e deputetit Amir Ahmeti në Komisionin për Legjislacion, në vend të ish-deputetit Ibrahim Makolli.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Halit Krasniqi, Arben Gashi, Teuta Haxhiu, Shaip Muja, Sadri Ferati dhe Sabri Hamiti. Diskutimet e plota të tyre janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Xhevdet Neziraj**, i parashtroi pyetje ministrit të Administratës Publike lidhur me punësimin e pjesëtarëve të komunitetit Ashkali në institucionet publike.

Ministri **Mahir Yagcilar** iu përgjigj pyetjes së deputetit Neziraj.

Deputetja **Duda Balje**, i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit lidhur me botimin e teksteve mësimore në gjuhën boshnjake.

Ministri **Ramë Buja** iu përgjigj pyetjes së deputetes Balje.

Deputetja **Duda Balje**, i parashtroi pyetje ministrit të Pushteti Lokal lidhur me formimin e ndonjë komune të re, ku komuniteti Boshnjak përbënë shumicë.

Ministri **Slavisha Petroviq** iu përgjigj pyetjes së deputetes Balje.

3. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve plenare të mëparshme

Procesverbalet e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 28 (dy) dhe 29 korrik, u miratuan pa vërejtje.

4. Shqyrtimi i Raportit të parë për zbatimin e Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës, për vitin 2011, lidhur me Raportin e progresit

Kryetari ftoi përfaqësuesin e komisionit funksional që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë Raportin e parë për zbatimin e Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës, për vitin 2011, lidhur me Raportin e progresit.

Kryetari i Komisionit për Integritet Evropian, Lutfi **Haziri**, tha se është detyrë e vazhdueshme e këtij komisioni funksional të Kuvendit për të përcjellë, monitoruar dhe raportuar mbi gjendjen dhe arritjet që ky komision dhe institucionet e Kuvendit arrijnë t'i realizojnë. Plani i parë tremujorë është realizuar pjesërisht, për shkak se tremujori i parë fillon të llogaritet prej prillit e tutje. Deri më 1 shtator, komisioni funksional dhe Kuvendi duhet t'i miratojnë edhe një numër të madh të ligjeve, në mënyrë që 12 tetori, atë ditë kur do të paraqitet Raporti final për Kosovën, këtë vit të përmbajnë vlerësime më pozitive se sa raportet tjera. Raporti i dytë që do të paraqitet, do të jetë më pozitiv se sa ky që sot e kemi paraqitur.

Në emër të komisionit parlamentar, por dhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës ju ftoj që sot ta miratoni Raportin e parë të Progresit, të paraqitur në tremujorin e parë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Blerta Deliu-Kodra, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar "Vetëvendosje", Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Blerim Shala, në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Sasha Milosavljeviq dhe në emër të Grupit Parlamentar "6+", Albert Kinolli, si dhe deputetët Hydajet Hyseni, Zenun Pajaziti, Sabri Hamiti dhe Amir Ahmeti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Raportit. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 69,

Kundër----- 1,

Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportin e parë për zbatimin e Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës, për vitin 2011, lidhur me Raportin e progresit.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregti të jashtme

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për tregti të jashtme.

Zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi**, në emër të Qeverisë së Kosovës arsyetoi nevojën për nxjerrjen e Projektligjit për tregti të jashtme.

Në vazhdim, zëvendëskryeministri tha se me qëllim të përafrimit të këtij Projektligji me legjislacionin e BE-së dhe me rregullativën e Organizatës Botërore të Tregtisë, ky Projektligj ka hyrë si prioritet në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në hartimin e një ligji të ri.

Qëllimi i këtij Projektligji është përcaktimi i rregullave të përgjithshme në ushtrimin e tregtisë me jashtë, përcaktimi i procedurave dhe kritereve të importit, eksportit dhe transitit të mallit, shërbimeve dhe pasurive kapitale. Fushëveprimi i këtij projektligji është blerja dhe shitja e mallrave dhe ushtrimi i ndërmjetësimit tregtar në tregun e brendshëm dhe në atë të jashtëm.

Me këtë Projektligj rregullohet veprimtaria tregtare, që mund të ushtrohet nga personat vendorë dhe ata të huaj, nga personat fizikë dhe juridikë të regjistruar në pajtim me ligjin përkatës për ushtrimin e aktiviteteve tregtare.

Hyrja në fuqi e këtij ligji do të ketë efekte pozitive në fushën e tregtisë, duke marrë parasysh sigurinë e mallrave, mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve, të kafshëve dhe bimëve, mbrojtjen e mjedisit dhe të natyrës, të cilat kanë për qëllim fushëveprimin brenda këtij ligji.

Në fund, zëvendëskryeministri kërkoi nga deputetët e Kuvendit ta miratojnë, në parim, Projektligjin për tregti të jashtme.

Pas arsyetimit të Projektligjit nga ana e zëvendëskryeministrit Kuçi, kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për tregti të jashtme.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomi, Tregti dhe Industri, deputeti **Zenun Pajaziti**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Justina Pula, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Teuta Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Biserka Kostiq dhe në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 38,

Kundër----- 29,

Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për tregti të jashtme.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomi, Tregti dhe Industri, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për marrëveshjet ndërkombëtare

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për marrëveshjet ndërkombëtare.

Ministri **Enver Hoxhaj**, në emër të Qeverisë së Kosovës arsyetoi nevojën për nxjerrjen e Projektligjit për marrëveshjet ndërkombëtare.

Në vazhdim, ministri Hoxhaj tha se ky Projektligj krijon bazën ligjore për rregullimin e marrëdhënieve në mes të dy apo shumë palëve përmes marrëveshjeve ndërkombëtare.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenin 18, në paragrafin 5, kërkon rregullimin e parimeve dhe të procedurave për ratifikimin dhe kontestimin e marrëveshjeve ndërkombëtare me një ligj të veçantë.

Me këtë projektligj përcaktohen procedurat e negocimit, të nënshkrimit, të ratifikimit, të rezervave dhe të deklaratave, të ndryshimit dhe të plotësimit të tërheqjes, si dhe të zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, pavarësisht se cili institucion ose zyrtar ka lidhur ose nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare në emër të shtetit apo të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Në fund, ministri kërkoi nga deputetët e Kuvendit ta miratojnë, në parim, Projektligjin për marrëveshjet ndërkombëtare.

Pas arsyetimit të Projektligjit nga ana ministrit Hoxhaj, kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për marrëveshjet ndërkombëtare.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Punë të Jashtme, deputeti **Albin Kurti**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Shaip Muja, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sabri Hamiti, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Albin Kurti, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, Suzana Novoberdali, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Sasha Milosavljeviq dhe në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Rasim Demiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 76,

Kundër-----0,

Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi, në parim, Projektligjin për marrëveshjet ndërkombëtare.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Jashtme, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregullore dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Ministri **Bajram Rexhepi**, në emër të Qeverisë së Kosovës tha se arsyeja për hartimin e këtij projektligji qëndron në faktin se aktualisht Qendra Kosovare për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim, vepron mbi bazën ligjore të UNMIK-ut, gjegjësisht të Rregullores numër 2008/18.

Për ta avancuar procesin e funksionimit të kësaj qendre, ministria e Punëve të Brendshme ka hartuar projektligjin i cili rregullon fushëveprimin e kësaj qendre. Qendra Kosovare për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim, si Agjenci e pavarur ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është një institucion i cili ofron trajnime dhe arsimin e lartë, zbatimin e politikave dhe të strategjive të trajnimit, arsimimit të lartë, si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike.

Për të gjitha institucionet e sigurisë publike, gjatë punës së hartimit të projektligjit dhe me pajtimin e të gjithë grupit punues, qeveritar dhe konsultimeve me mekanizmat përkatës është ndërruar edhe emërtimi i Qendrës së Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim në emërtimin e ri Akademia e Kosovës për Siguri Publike.

Kjo Akademi në të ardhmen e afërt do të përfshijë të gjitha kërkesat dhe synimet e institucioneve të sigurisë publike të Kosovës, si dhe Akademia t'i nënshtrohet procesit të akreditimit, për të ofruar shërbimet e edukimit të lartë për sigurinë publike.

Ky projektligj përmban gjithsej 9 kapituj dhe 22 nene, duke filluar nga dispozitat e përgjithshme, dispozitat shpjeguese, si dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Në fund, ministri Rexhepi kërkoi nga deputetët e Kuvendit ta miratojnë, në parim, Projektligjin për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Pas arsyetimit të Projektligjit nga ana ministrit Rexhepi, Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, deputeti **Rexhep Selimi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Fatmir Xhelili, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Vjollca Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Rexhep Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, Gëzim Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Sasha Milosavleviq dhe në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Rasim Demiri, si dhe deputetët Xhevaire Izmaqu, Haki Demolli, Zenun Pajaziti dhe Burim Ramadani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në fund, ministri Rexhepi dha sqarime në vërejtjet e deputetëve lidhur me këtë projektligj.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 64,
Kundër----- 22,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi, në parim, Projektligjin për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregullore dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Qendrën historike të Prizrenit

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për Qendrën historike të Prizrenit.

Ministri **Dardan Gashi**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi nevojën për nxjerrjen e Projektligjit për Qendrën historike të Prizrenit.

Në vazhdim, ministri Gashi tha se ky projektligj parashihet edhe me Pakon e Ahtisarit dhe e obligon Qeverinë dhe Kuvendin që ta nxjerrin këtë projektligj. Gjithashtu, nxjerrja e këtij projektligji parashihet edhe në Raportin e progresit të Komisionit Evropian.

Po ashtu, ky ligj ndikon drejtpërdrejt në marrëdhëniet e Republikës së Kosovës me miqtë dhe aleatët e Republikës së Kosovës.

Projektligji është në përputhshmëri të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Në fund, ministri Gashi kërkoi nga deputetët e Kuvendit ta miratojnë, në parim, Projektligjin për Qendrën historike të Prizrenit.

Pas arsyetimit të Projektligjit nga ana ministrit Gashi, Kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për Qendrën historike të Prizrenit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, deputeti **Nait Hasani**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Nijazi Idrizi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Salih Morina, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Burim Ramadani, në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, Sevdije Lama dhe në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Sasha Milosavleviq, si dhe deputetët Emilja Rexhepi, Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Afrim Kasolli, Jakup Krasniqi, Goran Marinkoviq dhe Ardian Gjini, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në fund, ministri Gashi dha sqarime në vërejtjet e deputetëve lidhur me këtë projektligj.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 44,
Kundër----- 46,
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, nuk e miratoi, në parim, Projektligjin për Qendrën historike të Prizrenit.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare.

Ministri **Mahir Yagcilar**, në emër të Qeverisë së Kosovës arsyetoi nevojën për nxjerrjen e Projektligjit për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare.

Në vazhdim, ministri Yagcilar tha se me këtë projektligj krijohet korniza ligjore për të drejtën për të asociuar dhe themeluar OJQ në Republikën e Kosovës. Projektligji përbëhet prej 27 neneve dhe mbulon aspektet më të rëndësishme të organizatave joqeveritare, ku përfshihen qëllimi dhe fushëveprimi, përkufizimet, liria e asociimit, mosshpërndarja e të ardhurave, nocioni i organizatave joqeveritare në Kosovë, mënyrën dhe procedurat e themelimit të shoqatave dhe fondacioneve në Kosovë. Gjithashtu, OJQ-të e vendit të huaj dhe ato ndërkombëtare, asociimi i personave juridikë, regjistrimi i OJQ-ve, refuzimi i regjistrimit, statusi ligjor, regjistri i OJQ-ve, udhëheqja e brendshme e shoqatave dhe fondacioneve, konflikti i interesave dhe detyrimi në lojalitet, ndalimi i mbledhjes së fondeve, fushatave dhe mbështetjes së kandidatëve dhe partive politike, pasuria dhe mjetet, statusi për përfitim publik, obligimet për raportimin financiar dhe aktivitetet për OJQ-të me status për përfitim publik, pezullimi revokimi dhe tërheqja vullnetare e statusit për përfitim publik, shuarja e OJQ-së, çregjistrimi i OJQ-së, ankesat, aktet nënligjore dhe hyrja në fuqi e ligjit.

Projektligji është në pajtim me Kushtetutën dhe me standardet, marrëveshjet, konventat dhe detyrimet ndërkombëtare, si dhe është përafshuar me parimet e përgjithshme të Bashkimit Evropian në fushën e shoqërisë civile.

Në fund, ministri Yagcilar kërkoi nga deputetët e Kuvendit ta miratojnë, në parim, Projektligjin për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare.

Pas arsyetimit të Projektligjit nga ana ministrit Yagcilar, kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Arsim, Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, deputeti **Idriz Vehapi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sadri Ferati, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për

Kosovë të Re, Jeton Svirca dhe në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Enis Kervan, si dhe deputeti Haki Demolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 65,
Kundër-----0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi, në parim, Projektligjin për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Arsim, Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregullore dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për organizmat e modifikuar gjenetikisht

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për organizmat e modifikuar gjenetikisht.

Ministri **Bleran Stavileci**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi nevojën për nxjerrjen e Projektligjit për organizmat e modifikuar gjenetikisht.

Në vazhdim, ministri Stavileci tha se ky Projektligj synon ta rregullojë këtë çështje duke i plotësuar zbrazëtitat e deritashme ligjore dhe duke u bazuar mbi parimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e rendimenteve në kulturat bujqësore, si dhe krijon mundësi për t’u fuqizuar rezistenca kundër sëmundjeve të ndryshme, pesticideve, hibrideve, si dhe ndikimit potencial të tyre në shëndetin e njerëzve dhe mjedisit. Fushëveprimi i këtij projektligji është krijimi i një infrastrukture të përshtatshme ligjore për çështjet që kanë të bëjnë me organizmat e modifikuar gjenetikisht në nivel sa më të avancuar, si në aspektin profesional, ashtu edhe në atë praktik.

Me krijimin e kësaj kornize ligjore i ofrohet siguri më e madhe edhe njeriut për mbrojtjen e shëndetit të tij, në rastet kur kryhet lirimi i qëllimshëm i organizmave të modifikuar gjenetik dhe kur vendosen në treg prodhimet që përmbajnë organizma të tillë.

Në fund, ministri kërkoi nga deputetët e Kuvendit ta miratojnë, në parim, Projektligjin për organizmat e modifikuar gjenetikisht.

Pas arsyetimit të Projektligjit nga ana ministrit Stavileci, kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për organizmat e modifikuar gjenetikisht.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, deputeti **Nait Hasani**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Nijazi Idriizi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Afërdita Shaqiri-Berisha, në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, Liburn Aliu dhe në emër të

Grupit Parlamentar të AAK-së, Time Kadrijaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 67,
Kundër-----1,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për organizmat e modifikuar gjenetikisht.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregullore dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

11. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Kompanisë së Ujësjiellit rajonal “ Hidrodrini” për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010

Kryetari i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, **Ali Sadriu**, në emër të Komisionit, para deputetëve të Kuvendit paraqiti dhe arsyetoi Raportin me rekomandime lidhur me Raportin e auditimit të pasqyrave financiare të Kompanisë së Ujësjiellit rajonal “ Hidrodrini” për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Raporti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të Kompanisë së Ujësjiellit rajonal “ Hidrodrini” për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010, është i kualifikuar. Komisioni ka analizuar këtë Raport dhe ka hartuar disa rekomandime lidhur me këtë, të cilat ia propozon Kuvendit t'i miratojë.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Kompanisë së Ujësjiellit rajonal “ Hidrodrini” për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Valbona Dibra, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Salih Morina, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Afrim Hoti, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Bali Muharremaj, në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, Sevdije Lama, si dhe deputetët Armend Zemaj dhe Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 60,
Kundër----- 3,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Raporti me rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me Raportin e auditimit të pasqyrave financiare të Kompanisë së Ujësjetës së rajonal “ Hidrodrini”, për vitin 2010.
2. Kompania e Ujësjetës së rajonal “ Hidrodrini”, të ndërmarë masa konkrete për rritjen e efikasitetit dhe të performancës në menaxhimin dhe në kontrollin e brendshëm të kësaj kompanie.

12. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2010

Kryetari i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, **Ali Sadriu**, në emër të Komisionit, para deputetëve të Kuvendit paraqiti dhe arsyetoi Raportin me rekomandime lidhur me Raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2010.

Komisioni ka analizuar këtë Raport, theksi deputeti Sadri, dhe ka konstatuar se ka pasur disa lëshime, por nuk është i kualifikuar. Andaj, me qëllim të përmirësimit të lëshimeve që janë cekur në Raportin e auditimit, Komisioni ka hartuar rekomandimet, të cilat i propozon Kuvendit që t’i miratojë.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramiz Lladrovci, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Bali Muharremaj, në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, Suzan Novoberdali, si dhe deputeti Hydajet Hyseni, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	69,
Kundër-----	2,
Abstenime-----	2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Raporti me rekomandime i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me Raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2010.
2. Obligohet Institucioni i Avokatit të Popullit që në afat prej tre muajve t'i raportojë me shkrim Kuvendit, përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për veprimet e ndërmarra lidhur me të gjitha të gjeturat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

13. Propozimi i Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re për emërimin e deputetit Amir Ahmeti në Komisionin për Legjislacion, në vend të ish-deputetit Ibrahim Makolli.

Kryesuesi kërkoi nga deputetët që me ngritje dore të deklaroheni për propozimin e Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, mori këtë:

V E N D I M

Deputeti Amir Ahmeti, emërohet anëtar i Komisionit për Legjislacion, në vend të ish-deputetit Ibrahim Makolli

14. Propozimi i Grupi Parlamentar të PDK-së për emërimin e dy anëtarëve në komisionet parlamentare

Kryesuesi i njoftoi deputetët se në bazë të marrëveshjes së Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re dhe të Grupit Parlamentar të PDK-së, si partner të koalicionit qeverisës, me qëllim të angazhimit të secilit deputet të Kuvendit në punën e komisioneve parlamentare, i kanë propozuar Kuvendit zëvendësimin e dy anëtarëve, nga radha e GP të KKR-së, në komisionet parlamentare, me dy anëtarë nga radha e GP të PDK-së.

Kryesuesi kërkoi nga deputetët që me ngritje dore të deklarohen për propozimin e cekur më lart. Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputeti Adem Grabovci, emërohet anëtar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në vend të deputetit Muhamet Mustafa.
2. Deputeti Elmi Reçica, emërohet anëtar i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, në vend të deputetes Myzejene Selmani.

Kryesuesi e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 18:00.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale